



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

---

**Njoftim Paraprak Përqendrimi**

Rasti: Përfitim Kontrolli Trans-Atlantic Petroleum Ltd - Stream Oil & Gas Ltd

Në datën 30 Shtator 2014, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të Marrevshjes për Blerjen e 100% të kuotave të Stream Oil & Gas Ltd nga TransAtlantic Petroleum Ltd.

Marrëveshja është nënshkruar midis palëve më datë 2 Shtator 2014, me objekt përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë Stream Oil & Gas Ltd nga shoqëria TransAtlantic Ltd. Njoftimi është bërë për shkak të xhirove që Stream Oil & Gas Ltd ka realizuar në Shqipëri me anë të degës së saj Stream Albania Sh.p.k.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **TransAtlantic Petroleum Ltd** është një shoqëri ndërkombëtare për prodhimin e energjisë me objekt blerjen, shfrytëzimin, zhvelimin dhe proshimin e naftës dhe gazit natyror. Ajo nuk është prezente në Shqipëri dhe ushtron aktivitetin e saj në Turqi dhe Bullgari;
- **Stream Oil & Gas Ltd** është një shoqëri e listuar në Bursë dhe ka si objekt veprimtarinë e prodhimit të naftës dhe gazit. Ajo ka selinë e saj në Kanda dhe zotëron filialë në ishujt Cayman dhe në Shqipëri ku ka degën e saj prej vitit 2005, shoqërinë Stream Albania sh.p.k.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10, pika 1, shkronja b), 12, pika 1) dhe 2, të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)**